



Forma juridike: Shoqëri Aksionare

Data e themelimit: 04 Gusht 2015

Numri unik i indentifikimit(NIPT): L 42011023 U

Adresa e Selise: Rr.Durrësit,ND nr.6,Zona Kadastrale 8330, Tiranë

E-mail: info@iutecredit.al

Objekti tregtar: Import,eksport dhe tregtim mallrash

Pasqyrat Financiare 2015

(Mbyllur më 31.12.2015)

Pasqyra financiare: Individuale(jokonsoliduara)

Periudha kontabel: Nga 01.01.2015 deri më 30.12.2015

Data e mbylljes: 05 Shkurt 2015

Monedha: Leke

Shkalla e rrumbullakimit: ne leke

Tiranë, Shkurt 2016

Tabela e përmbajtjes

A. RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR.....	0
B. PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR(BILANCI).....	2
C. PASQYRA E PERFORMANCES	
PASQYRA E TE ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE.....	3
PASQYRA E TE ARDHURAVE GJITHEPERFSHIRESE.....	3
D. PASQYRA E FLUKSIT TE MJETEVE MONETARE.....	4
E. PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITALIN NETO.....	5
F. SHENIME PER PASQYRAT FINANCIARE.....	6-14

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR(BILANCI)
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2015
(TË GJITHA SHUMAT JANË NË LEKË)

Nr	Përshkrimi i Elementëve	Shënime	Viti Raportues 31.12.2015	Viti Paraardhës 31.12.2014
I	AKTIVI			
1	Aktivet afatshkurtra	4		
	Mjete monetare ne arke dhe banke	4.1	5,950,336	12,698,733
	Hua dhe paradhënie për klientët		-	-
	Parapagime te dhena	4.2	188,231	191,441
	Te tjera aktive afatshkurtera		-	-
	Totalii aktiveve afatshkurtra		6,138,567	12,890,174
2	Aktivet afatgjata	5		
	Aktive afatgjata materiale	5.1	892,080	695,576
	Aktive afatgjata jo materiale		-	-
	Hua dhe paradhënie për klientët	5.2	67,349,807	-
	Te tjera aktive afatgjata		-	-
	Aktiv tatimor i shtyrë		-	-
	Totali i aktiveve afatgjata		68,241,887	695,576
	Totali i Aktivit		74,380,454	13,585,750
II	DETYRIMET DHE KAPITALI			
1	Detyrime afatshkurtra	6		
	Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve financiare		-	-
	Detyrime të tjera	6.1	711,159	356,596
	Totali i detyrimeve afatshkurtra		711,159	356,596
2	Detyrimet afatgjata	7		
	Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve financiare	7.1	72,551,338	1,908,146
	Detyrime të tjera		-	-
	Detyrim tatimor i shtyrë		-	-
	Totali i detyrimeve afatgjata		72,551,338	1,908,146
	Totali i Detyrimeve		73,262,497	2,264,742
3	Kapitali dhe Rezervat	8		
	Kapitali aksionar		15,000,000	15,000,000
	Primi i Lidhur me Kapitalin (-)		-	-
	Rezerva Rivlerësimi		-	-
	Rezerva ligjore		-	-
	Rezerva Statutore		-	-
	Rezerva të tjera		-	-
	Fitimet(humbja) e pashpërndara		(3,678,992)	-
	Fitimi (humbja) e vitit financiar	9	(10,203,051)	(3,678,992)
	Totali i Kapitalit dhe Rezervave		1,117,957	11,321,008
	TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT		74,380,454	13,585,750

Shënimet mbi pasqyrat financiare në faqet vijuese janë pjesë përbërese e këtyre pasqyrave financiare.

PASQYRA E PERFORMANCËS
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2015
(TË GJITHA SHUMAT JANË NË LEKË)

A.Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve
 (Shpenzimet e shfrytëzimit të klasifikuara sipas natyrës)

Nr	Përshkrimi i Elementëve	Shënime	Viti Raportues 31.12.2015	Viti Paraardhës 31.12.2014
	Të ardhura nga interesat	9.1	3,227,585	4,652
	Shpenzime për interesa	9.1	(4,238,957)	(106,927)
	Te ardhura neto nga interesi		(1,011,372)	(102,275)
	Të ardhura nga komisionet	9.1	9,367,214	-
	Të tjera të ardhura (gjyba etj.)	9.1	7,334,228	-
	Totali i të ardhurave të tjera		16,701,442	-
	Humbje neto nga zhvlerësimi i huave të dhëna	9.2	(7,620,498)	-
	Kostot administrative	9.3	(18,773,179)	(3,597,949)
	Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	5.1	(192,358)	(21,232)
	Fitimi nga aktiviteti kryesor		(10,895,965)	(3,721,456)
	Të ardhurat dhe shpenzimet financiare	9.4		
	Te ardhurat dhe shpenzimet financiare		-	-
	Fitim/Humbja nga kursi i këmbimit të aktivitetit financiar		717,914	52,881
	Totali i të ardhurave dhe shpenzimeve financiare		717,914	52,881
	Fitimi/(Humbja) Para Tatimit		(10,178,051)	(3,668,575)
	Shpenzime (Të Ardhura) për Tatimin mbi Fitimin	10	(25,000)	(10,417)
	Shpenzimi Aktual i Tatimit mbi Fitimin		(25,000)	(10,417)
	Shpenzime (Të Ardhura) i Tatim Fitimit të Shtyrë			
	Fitimi/(Humbja) e Vitit Financiar		(10,203,051)	(3,678,992)

B.Pasqyra e të ardhurave gjithpërfshirëse

Nr	Përshkrimi i Elementëve	Shënime	Viti Raportues 31.12.2015	Viti Paraardhës 31.12.2014
1	Fitimi/(Humbja) e Vitit Financiar		(10,203,051)	(3,678,992)
2	Diferencat nga Përkth. i Monedhes në Veprimt. të Huaja	.	-	-
3	Diferencat nga Rivlerësimi i Aktiveve Afatgjata Materiale	.	-	-
4	Diferencat nga Rivlerësimi i Aktiveve Fin. të Mbaj.Shitje	.	-	-
5	Pjesa e të Ardhurave Gjithpërfsh. nga Pjesëmarrjet	.	-	-
6	Të Tjera të Ardhura Gjithpërfshirëse për Vitin		-	-
7	Totali i të Ardhurave Gjithpërfsh. për Vitin (2-6)		-	-
	Totali i të Ardhurave/(Humbjeve) Gjithpërfshirëse (1+/-7)		(10,203,051)	(3,678,992)
	Pronarët e Njesise Mëmë		-	-
	Interesat Jo-Kontrolluese		-	-

Shënimet mbi pasqyrat financiare në faqet vijuese janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

PASQYRA E FLUKSIT TE MJETEVE MONETARE (METODA INDIREKTE)
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2015
(TË GJITHA SHUMAT JANË NË LEKË)

Nr	Pershkrimi i Elementeve	Shënimet	Viti Raportues 31.12.2015	Viti Paraardhës 31.12.2014
I	Fluksi i Mjeteve Monetare nga Aktiv.Shfrytëzimit			
	Fitimi/(Humbja) e Vitit Financiar		(10,178,051)	(3,668,575)
	Rregullimet për shpenzimet jomonetare:			
	Amortizimi dhe zhvlerësimi		192,358	21,232
	Humbje/(Fitim) nga shitja e aktiveve afatgjata		-	-
	Humbje neto nga zhvlerësimi i huave dhe paradhanie klienteve		7,620,498	-
	E ardhura neto nga interesat		-	-
	Ndryshimi në provigjone për debitore të tjera dhe detyrime të mundeshme		-	-
	Efekti i ndryshimeve në kurset e kërmbimit mbi gjendjen e parase		-	-
	Te tjera		-	-
	Ndryshimet në Aktivet dhe Detyrimet e Shfrytëzimit			
	Renie/(Rritje) në hua për klientët		(74,970,305)	-
	Renie/(Rritje) në aktive të tjera		3,210	(191,441)
	Renie/(Rritje) në detyrime të tjera		354,563	2,264,742
	Interesi i arkëtuar		-	-
	Interesi i paguar		-	-
	Tatimi mbi fitimin i paguar		(25,000)	(10,417)
	Mjete Monetare Neto nga Aktiv. e Shfrytëzimit		(77,002,727)	(1,584,459)
II	Fluksi i Mjeteve Monetare nga Aktiv. Investimit			
	Blerje aktiveve afatgjata materiale		(388,862)	(716,808)
	Blerje aktiveve afatgjata jomateriale		-	-
	Te ardhura neto nga shitja e aktiveve afatgjata materiale		-	-
	Te ardhura neto nga blerja dhe maturimi i letrave me vlerë		-	-
	Mjete Monetare Neto nga Aktiv. e Investimit		(388,862)	(716,808)
III	Fluksi i Mjeteve Monetare nga Aktiv. Financimit			
	Hyrje nga emetimi i kapitalit aksionar		-	15,000,000
	Hyrje nga huamarrje afatgjata		70,643,192	-
	Dividend i paguar		-	-
	Rritje e borxhit e varur		-	-
	Mjete monetare Neto nga Aktiv. e Financimit		70,643,192	15,000,000
	Rritje/Rënie Neto në Mjetet Monetare dhe Ekuivalentet e Tyre		(6,748,397)	12,698,733
	Mjetet Monetare dhe Ekuivalentet në Fillim të Periudhës		12,698,733	-
	Mjetet Monetare dhe Ekuivalentet në Fund të Periudhës		5,950,336	12,698,733

Shënimet mbi pasqyrat financiare në faqet vijuese janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2015
(TË GJITHA SHUMAT JANË NË LEKË)**

Nr	Përshkrimi i Elementëve	Kapitali i Aksionar	Primi i Lidhur me Kapitalin	Rezerva Rivlerësimi	Rezerva Ligjore, Rezerva Statutore & të Tjera	Fitimet(humbja) e Pashpërndara	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Pozicioni Financiar më 31 Dhjetor 2013								
A	2013	-	-	-	-	-	-	-
	Kontabël	-	-	-	-	-	-	-
Pozicioni Financiar i Rideklaruar më 1 Janar 2014								
		-	-	-	-	-	-	-
Të Ardhura Totale								
1	Gjithëpërfshirëse për Vitin:							
	Fitimi / Humbja e Vitit	-	-	-	-	-	(3,678,992)	(3,678,992)
	Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-	-	-	-
	Totali i të Ardhurave							
	Gjithëpërfshirëse për Vitin:	-	-	-	-	-	(3,678,992)	(3,678,992)
Transaksionet me Pronarët e Njesisë Ekonomike të Njohura								
2	Direkt në Kapital:							
	Emetimi i Kapitalit të Nënshkruar (+Ndryshimet Brenda Zerave)	15,000,000	-	-	-	-	-	15,000,000
	Dividendë të Paguar	-	-	-	-	-	-	-
	Totali i Transaksioneve me Pronarët e Njesisë Ekonomike	15,000,000	-	-	-	-	-	15,000,000
Pozicioni Financiar më 31 Dhjetor 2014								
B	2014	15,000,000	-	-	-	-	(3,678,992)	11,321,008
	Kontabël	-	-	-	-	-	-	-
Pozicioni Financiar i Rideklaruar më 1 Janar 2015								
		15,000,000	-	-	-	-	(3,678,992)	11,321,008
Të Ardhura Totale								
1	Gjithëpërfshirëse për Vitin:							
	Fitimi / Humbja e Vitit	-	-	-	-	-	(10,203,051)	(10,203,051)
	Gjithëpërfshirëse	-	-	-	-	-	-	-
	Totali i të Ardhurave							
	Gjithëpërfshirëse për Vitin:	-	-	-	-	-	(10,203,051)	(10,203,051)
Transaksionet me Pronarët e Njesisë Ekonomike të Njohura								
2	Direkt në Kapital:							
	Emetimi i Kapitalit të Nënshkruar (+Ndryshimet Brenda Zerave)	-	-	-	-	(3,678,992)	3,678,992	-
	Dividendë të Paguar	-	-	-	-	-	-	-
	Totali i Transaksioneve me Pronarët e Njesisë Ekonomike	-	-	-	-	(3,678,992)	3,678,992	-
Pozicioni Financiar më 31 Dhjetor 2015								
C	2015	15,000,000	-	-	-	(3,678,992)	(10,203,051)	1,117,957

Shënimet mbi pasqyrat financiare në faqet vijuese janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga drejtimi i "IuteCredit Albania" sh.a dhe janë firmosur nga:

Administratori

Bealba Mata



**SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2015
(TË GJITHA SHUMAT JANË NË LEKË)**

1. Informacione te pergjitheshme

Shoqëria tregtare "IuteCredit Albania" sh.a, është themeluar si një shoqëri aksionare më 04 Gusht 2014 dhe vepron në përputhje me ligjin "Për tregtarë dhe shoqëritë tregtare" dhe ligjeve të tjera që rregullojnë biznesin në Shqipëri.

Në regjistrin tregtar (QKR) shoqëria është e identifikuar me NUIS-in L42011023U dhe ka selinë kryesore e saj në rrugë "....." Tiranë.

Kapitali i regjistruar i saj është 15.000.000 leke dhe zotërohet nga aksioneri i vetëm shoqëria "AS IuteCredit Europe" me qendër në Estoni e cila është pala kontrolluese finale.

Objekti kryesor i veprimtarisë së shoqërisë janë aktivitetet në fushën e operacioneve tregtare dhe financiare të kredidhenies. Për këtë shoqëria është e pajisur me licencën nr.32 datë 31 Mars 2015 të BSH si një institucion financiar i mikrokredisë.

2. Bazat e Pergatitjes

Deklaratë e pajtueshmërisë me SNRF-të

Pasqyrat financiare (individuale) për qëllime të përgjithshme janë përgatitur dhe paraqiten në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF-të) dhe me kërkesat e ligjit "Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare".

Bazat e matjes të përdorura

Pasqyrat financiare, përveç informacionit të flukseve të mjeteve monetare, janë përgatitur duke përdorur *bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara të kontabilitetit*. Mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, elementët njihen si aktive, detyrime, kapital, të ardhura apo shpenzime kur ato plotësojnë përkufizimet dhe kriteret e njohjes për këto zëra. Për matjen e vlerave monetare të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve, në pasqyrat e saj financiare, shoqëria ka zgjedhur si bazë matjeje kosto historike dhe në raste të veçanta baza të tjera matjeje të lejuara nga standardet.

Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat financiare paraqiten në Lekë shqiptar ("Leke"), e cila është monedha kryesore e mjedisit ekonomik në të cilin vepron shoqëria (monedha funksionale). I gjithë informacioni financiar paraqitet në "Leke", përveç kur shprehet ndryshe.

3. Përmbledhje e politikave kontabël

Parimet kontabile më domethënëse që janë përdorur nga shoqëria, janë si më poshtë:

Monedhat e huaja

Transaksionet e kembimeve në monedhe të huaja regjistrohen me kursin zyrtar të këmbimit të shpallur në ditën e transaksionit. Aktivët dhe pasivët monetarë të emetuara në monedhe të huaja në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin zyrtar të këmbimit të shpallur në datën e bilancit.

Fitimi ose humbja nga ndryshimi i kurseve të këmbimit është diferenca midis kostos së amortizuar në monedhën funksionale në fillim të periudhës, të rregulluara me interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kostos së amortizuar në monedhë të huaja të kthyer në monedhën funksionale me kursin e fundit të periudhës. Aktivët dhe detyrimet jo monetarë në monedhe të huaja, të cilat maten me vlerë të drejtë, kthehen në monedhën funksionale me kursin e datës së caktimit të vlerës së drejtë.

Diferencat që lindin nga kurset e kembimit regjistrohen në pasqyrën e veçante përmbledhese të të ardhurave.

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Leke/Euro	137.28	140.14

Interesi

Tëardhurat dhe shpenzimet nga interesat njihen si fitime ose humbje në pasqyrën e veçante përmbledhese të të ardhurave në bazë të metodës së interesit efektiv. Norma e interesit efektiv është norma që aktualizon pagesat dhe arketimet e ardhshme monetare gjatë jetës së aktivitetit, ose detyrimit financiar (ose kur është e pershtatshme një periudhë më e shkurtër) për t'i barazuar me vlerën kontabel të aktivitetit ose detyrimit financiar. Kur përlogarit interesin efektiv, shoqëria merr parasysh rrjedhjet e ardhshme të parave sipas kontratës, por jo humbje të ardhshme krediti.

Llogaritja e normës së interesit efektiv përfshin të gjitha komisionet e paguara ose të marra, të cilat janë një pjesë integrale e normës efektive të interesit. Kostot e transaksioneve janë kosto shtesë të lidhura drejtpërdrejt me blerjen, ose emetimin e një aktivi apo detyrimi financiar.

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat për aktivet dhe detyrimet e tregtueshme konsiderohen si pjesë e aktivitetit tregtar dhe paraqiten së bashku me të gjitha ndryshimet e tjera në vlerën e drejte të aktiveve dhe detyrimeve të tregtueshme në fitimin neto nga tregtimi.

Tarifa dhe komisione

Të ardhurat dhe shpenzimet nga tarifat dhe komisionet, të cilat janë pjesë integrale e normës së interesit efektiv në një aktiv ose detyrim financiar, përfshihen në matjen e normës së interesit efektiv.

Shpenzime të tjera për komisione dhe tarifa lidhen kryesisht me tarifa transaksionesh ose shërbimesh, të cilat shpenzohen në momentin që shërbimet përfitohen.

Shpenzimet për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore

Detyrimet për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore njihen si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kur ato ndodhin. Ato llogariten sipas sipas përcaktimeve ligjore.

Shoqëria njeh gjithashtu si detyrim vlerën e paskontuar të kostos së vlerësuar në lidhje me lejen vjetore që pritet të paguhet dhe detyrimet për përfitime të tjera afatshkurtra.

Aktive dhe detyrime financiare

Huate dhe parapagimet dhe depozitat njihen fillimisht me kosto në datën e krijimit. Të gjitha aktivet dhe detyrimet financiare të tjera fillimisht njihen në datën e tregtimit, date në të cilën shoqëria behet pale e kontratës.

Shoqëria ç'regjistron një aktiv financiar nëse të drejtat kontraktuale ndaj rrjedhjeve monetare që vijne nga aktivi skadojnë ose nëse i transferon të drejtat për të marrë rrjedhat e kontraktuara të parave nga aktivet financiare nepermjet një transaksioni në të cilin transferohen të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronesisë mbi aktivin financiar.

Çdo interes në aktive financiare të transferueshme, që përfitohet ose mbahet, njihet si një aktiv ose detyrim me vete. Detyrimet financiare ç'regjistrohen nëse detyrimet kontraktuale mbarojnë, janë anuluar ose kanë skaduar.

Aktivitet dhe detyrimet financiare korrpensohen dhe shuma neto paraqitet në bilanc kur, dhe vetëm kur, Shoqëria ka të drejtën ligjore për të kompensuar shumat dhe ajo synon ose të shlyejë ato në bazë neto ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.

Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten në bazë neto vetëm atëherë kur lejohet sipas SNRF.Bankes.

Kostoja e amortizuar e një aktivi ose detyrimi financiar është vlera me të cilën aktivi ose detyrimi njihet në momentin fillestar, duke i zbritur pagesat e principalit, plus ose minus amortizimin e akumuluar,

duke përdorur metodën e interesit efektiv për çdo diferencë ndërmjet vlerës fillestare të njohur dhe vlerës në maturitet, minus çdo zbritje për efekt zhvlerësimi.

Huat dhe paradheniet për klientet

Huat dhe paradheniet për klientet janë aktive financiare jo-derivative, me pagesa fikse ose të përcaktueshme, të cilat nuk janë kuotuar në tregje aktive dhe shoqëria nuk ka për qëllim t'i shesë në periudha afatshkurtra. Huat dhe paradheniet klasifikohen si hua dhe të arketueshme. Huat dhe paradheniet fillimisht njihen me vlerën të drejtë plus kosto direkte transaksioni dhe në vazhdim maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimi i tatimit fitimit

Për vitin financiar 2015 shoqëria është e klasifikuar si biznes i vogël nën 2.000.000 leke dhe si e tillë paguan tatim të thjeshtuar mbi fitimin një shume fikse prej 25.000 leke.

Paraja dhe ekuivalentet e saj

Paraja dhe ekuivalentet e saj përfshijnë kartemonedha, monedha, gjendje të pakushtezuara të Bankës Qendrore, llogari rrjedhese dhe aktive shumë likuide me afat maturimi me pak se tre muaj, të cilat nuk ndikohen shumë nga ndryshimet në vlerën e drejtë dhe përdoren nga shoqëria për administrimin e angazhimeve afatshkurtra. Këto aktive mbahen me koston e amortizuar në pasqyrën e vecante të pozicionit financiar.

Aktivet e afatgjata materiale

Zerat e aktiveve afatgjata materiale paraqiten me koston minus zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga renia në vlerë.

Kostot përfshijnë shpenzimet që janë të lidhura direkt me blerjen e aktivit. Kosto e aktivit të ndërtuar vetë përfshin koston e materialeve dhe punës direkte dhe çdo kosto tjetër direkte të lidhur me venien e aktivit në kushtet e punës për përdorimin e parashikuar, kostot e çrëntimit dhe heqjen e pjesëve dhe restaurimin e zonës në të cilat ato janë vendosur. Pjesë të një prone, makinerie dhe pajisjeje që kanë jetëgjatësi të ndryshme kontabilizohen si elemente të vecanta (pjesë perberese) të aktiveve afatgjata materiale. Kostoja e zëvendësimit të një pjesë të një elementi të aktiveve afatgjata materiale njihet me vlerën e mbartur të elementit, nëse është e mundur që përfitime ekonomike të ardhshme, që i atribuohen atij elementi, do të sjellin flukse hyrëse dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmëri. Kostot e shërbimeve të mirëmbajtjes së perditeshme të aktiveve afatgjata materiale njihen në pasqyrën përmbledhese të të ardhurave në momentin kur ato ndodhin.

Amortizimi njihet në pasqyrën përmbledhese të të ardhurave me anën e metodës së vlerës së mbetur.

Normat e përdorura janë:

- Mobilje zyre dhe pajisje të tjera 20 %
- Pajisje Informatike 25 %

Metoda e amortizimit, jetëgjatësia dhe vlera e mbetur rishikohen në datën e raportimit. Zhvlerësimi nuk llogaritet për aktivet në proces dhe aktivet e paamortizueshme.

Aktivet afatgjata jomateriale

Programet kompjuterike të blera nga Shoqëria njihen me koston historike zvogëluar me amortizimin dhe humbjet e akumuluar nga renia në vlerë. Shpenzimet e metejshme mbi programet kompjuterike kapitalizohen vetëm kur këto shpenzime lidhen me rritjen e përfitimit të ardhshëm ekonomik prej këtij aktivi. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen në periudhën që ndodhin. Shpenzimi i amortizimit njihet në pasqyrën përmbledhese të të ardhurave, bazuar mbi metodën lineare të amortizimit gjatë jetës së vlerësuar të dobishme të programit kompjuterik, prej datës në të cilën ai është i gatshëm për përdorim. Jeta e dobishme ekonomike e programeve kompjuterike është pesë vjet.

Zhvlerësimi i aktiveve materiale edhe jo materiale

Shoqëria rishikon në fund të çdo periudhe raportuese vlerën kontabel neto të aktiveve materiale dhe jomateriale për të përcaktuar nëse ka të dhëna se keto aktive janë zhvlerësuar. Nëse ekzistojnë tregues të tillë, matet shuma e rikuperueshme e aktivit në mënyrë që të përcaktohet masa e zhvlerësimit (nëse ka).

Shuma e rikuperueshme është me e madhja midis vlerës së drejte minus kostot e shitjes dhe vlerës në perdorim. Nëse shuma e rikuperueshme e një aktivi vlerësohet të jetë me e vogël se vlera kontabel neto, vlera kontabel neto e aktivit zvogëlohet deri në shumën e rikuperueshme. Një humbje nga zhvlerësimi njihet menjëherë në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave, përveç nëse aktivi mbahet me shume të rivlerësuar, rast në të cilin humbja nga zhvlerësimi njihet si pakesim i rivlerësimit. Kur anulohet një humbje nga zhvlerësimi, vlera kontabel neto e aktivit rritet deri në vlerën e rishikuar të rikuperueshme, por jo aq sa vlera neto kontabel e rritur të tejkalojë vlerën kontabel neto që do të ishte përcaktuar nëse nuk do të ishte njohur humbja nga zhvlerësimi në vitet e mëparshme.

Një anulim i humbjes nga renia në vlerë njihet në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave, përveç se kur aktivi mbahet me vlerën e rivlerësuar rast në të cilin anulimi i humbjes nga renia në vlerë njihet si një rritje nga rivlerësimi.

Provigjionet

Një provigjion njihet nëse, si rezultat i ngjarjeve të mëparshme, Shoqëria ka një detyrim aktual ligjor ose konstruktiv, i cili mund të matet në mënyrë të besueshme dhe është e mundur që nxjerrje fondesh do të kërkohej për shlyerjen e këtij detyrimi.

Perdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon që Drejtimi të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime që ndikojnë zbatimin e politikave kontabel dhe vlerat e aktiveve, pasiveve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga keto vlerësime.

Vlerësimet dhe supozimet që lidhen me to rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabel njihen në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar dhe në periudhat vijuese të prekura.

4. Aktive afatshkurtëra**4.1 Aktive monetare (likuiditete në arke dhe bankë dhe bankën qendrore)**

Gjendjet e mjetet monetare në banke dhe arke, në fillim dhe fund të ushtrimit janë si më poshtë:

Nr	Përshkrimi i Elementëve	Monedha	Viti raportues 31.12.2015		Viti paraardhës 31.12.2014	
			Leke	Valute	Leke	Valute
1	Llogari bankare	LEK	5,946,307		12,695,245	-
						
2	Arka në leke	LEK	4,029		3,488	-
Shuma			5,950,336	x	12,698,733	x

Gjendjet e llogarive të likuiditeteve të paraqitura në pasqyrat financiare konfirmohen me nxjerrjet e llogarive bankare dhe inventaret fizike të monedhave në fund të ushtrimit. Tepërcat e shprehura në monedhë të huaj, janë përkthyer në leke duke përdorur kursin e këmbimit të shpallur nga B.Shqipërisë.

4.2 Parapagime të dhëna

Të drejtat e arketueshme,parapagime të dhena, në fillim dhe në fund të ushtrimit kontabël deklarohen si vijon:

	Viti Raportues 31.12.2015	Viti Paraardhës 31.12.2014
1 Parapagime te dhena		
Parapagime per qeran e zyrove	188,231	191,441
.....	-	-
Shuma	188,231	191,441

Drejtimi mendon se të gjitha kërkesat do të arketohen në një periudhë afatshkurter me vlerën e tyre nominale dhe nuk parashikon rënie në vlerë.

5. Aktivet Afatgjata

5.1 Aktivet Afatgjata Materiale(AAM-te)

Gjendjet dhe levizjet e aktiveve afatgjata materiale ne pasqyrat financiare paraqitet si vijon:

Gjendjet dhe levizjet	Toka	Ndertesa	Pajisje zyre - Mobilje	Pajisje zyre - Informatike	Te tjera	Totali
A Kosto e AAM-ve me 01.01.2015	-	-	203,200	281,218	232,390	716,808
Shtesat	-	-	81,800	116,530	190,532	388,862
Pakesimet	-	-	-	-	-	-
Kosto e AAM-ve 31.12.2015	-	-	285,000	397,748	422,922	1,105,670
B Amortizimi AAM-ve 01.01.2015	-	-	8,973	12,034	225	21,232
Amortizimi ushtrimit	-	-	85,857	75,063	31,438	192,358
Amortizimi per daljet e AAM-ve	-	-	-	-	-	-
Amortizimi i AAM-ve 31.12.2015	-	-	94,830	87,097	31,663	213,590
C Zhvleresimi AAM-ve 01.01.2015	-	-	-	-	-	-
Shtesat	-	-	-	-	-	-
Pakesimet	-	-	-	-	-	-
Zhvleresimi AAM-ve 31.12.2015	-	-	-	-	-	-
D Vlera neto e AAM-ve 01.01.2015	-	-	194,227	269,184	232,165	695,576
Vlera neto e AAM-ve 31.12.2015	-	-	190,170	310,651	391,259	892,080

Si politike kontabel per kontabilizimin dhe shpjegimin e AAM-ve, shoqeria ka zgjedhur modelin e koston(SNK-16). Ne koston e njohjes fillestare te një zëri të aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) jane përfshire çmimi blerjes, përfshire taksat doganore dhe taksat mbi blerjen jo të rimbursueshme, pasi zbriten skontot tregtare dhe zbritjet tregtare ose kostoja e ndertimit te tij, si dhe çdo kosto të ngarkueshme drejtpërdrejtë për të sjellë aktivin në vendin dhe kushtet e nevojshme që ai të jetë i përdorshëm në mënyrën e synuar nga drejtimi.

Per amortizimin e AAM-ve shoqeria ka zgjedhur metoden e vleres se mbetur, e njejtë me ato qe perdoren per qellime fiskale.

Ne datën e mbylljes se bilancit paraqiten me koston e tyre minus amortizimin e akumuluar dhe ndonje humbje te akumuluar nga zhvleresimi.

Vlera kontabël (neto) e AAM-ve eshte rishikuar nga drejtimi dhe eshte konstatuar se nuk gjenden indicacione te besueshme që ndonjë aktiv të jetë i zhvlerësuar dhe ka çmuar se vlerat neto te paraqitura nuk tejkalojne shumën e rikuperueshme te tyre .

5.1 Aktivët Afatgjata-Hua dhe paradhënie për klientët

Detyrimet afateshkurtera ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2015 paraqiten:

	Viti Raportues 31.12.2015	Viti Paraardhës 31.12.2014
1 Hua dhe paradhënie për klientët	74,970,304	-
2 Provigjone për zhvlerësimin e huave	(7,620,497)	-
	-	-
Shuma	67,349,807	-

6. Detyrime afatshkurtera**6.1 Detyrime të tjera**

Detyrimet afatgjata ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel paraqiten si vijon:

Emertimi	Viti Raportues 31.12.2015	Viti Paraardhës 31.12.2014
1 Detyrime te pagueshme		
Furnitore per mallra e sherbime	384,898	356,596
Tatim ne burim	127,140	-
Sigurime shoqerore & shendetesore	199,121	-
Shuma	711,159	356,596

7. Detyrime afatgjata**7.1 Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve financiare**

Detyrimet afatgjata ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel paraqiten si vijon:

Emertimi	Viti Raportues 31.12.2015	Viti Paraardhës 31.12.2014
1 Hua nga mëma-principal	68,207,980	1,801,219
2 Interesa te maturuara	4,343,358	106,927
	-	-
Shuma	72,551,338	1,908,146

8. Kapitali dhe Rezervat

Kapitali i regjistruar i shoqerise, i paraqitur ne bilanc, eshte i njejte me ate te percaktuar ne statutin e shoqerise dhe vendimet e depozituara ne QKR. Me 31.12. 2014 kapitali i regjistruar eshte 15,000,000 leke, i ndare ne 15,000 aksione me vlere nominale 1,000 leke/aksioni. Kapitali i regjistruar zoterohet nga aksionari i vetem "AS luteCredit Europe" me qender ne Estoni.

9. Fitimi (humbja) e vitit financiar-Te ardhurat dhe shpenzimet**9.1 Të ardhurat neto nga interesat dhe komisionet**

Nr	Emertimi	Viti raportues 31.12.2015	Viti paraardhës 31.12.2014
	Të ardhura nga interesat		
1	Hua dhe paradhënie klientëve	3,227,585	
2	Depozita bankare	-	
3	Të tjera	-	
	Shpenzime interesi		
1	Huamarrje nga mëma	(4,238,957)	(102,275)
2	Huamarrjet nga bankat	-	
3	Të tjera	-	
	Të ardhura nga komisionet dhe te tjera		
1	Të ardhura nga komisionet(akt.huadhenes)	9,367,214	
2	Të tjera të ardhura(gjoba)	7,334,228	
	Shuma	15,690,070	(102,275)

9.2 Humbje neto nga zhvlerësimi i huave të dhëna

Nr	Emertimi	Viti raportues 31.12.2015	Viti paraardhës 31.12.2014
	Zhvlerësimi i kredive për klientet		
1	me pak së 30 dite vonesë	5,970,000	-
2	30 deri në 90 dite vonesë	1,600,000	-
3	90 deri në 180 dite vonesë	50,498	-
4	180 deri në 360 dite vonesë		-
5	mbi 360 ditë vonesë		-
	Shuma	7,620,498	-

9.3 Shpenzime administrative

Shpenzimet operative perbehen nga : Pagat e personelit, shpenzimet per sigurimet shoqërore dhe shëndetsore, shpenzime per qera, etj, analiza e te cilave jepet ne pasqyren si ne vijim:

Emertimi	Viti Raportues 31.12.2015	Viti Paraardhës 31.12.2014
1 Kostot e personelit		
Pagat	(5,128,010)	(1,242,301)
Sigurimet shoqerore & shendetsore	(703,224)	(150,009)
3 Reklame & Publicitet	(2,872,279)	(120,180)
4 Qera zyre	(2,517,237)	(607,784)
5 Mirembajtje e aktiveve afatgjata	(17,011)	(138,978)
6 Shpenzime perfaqesimi	-	-
7 Shpenzime udhetimi dhe dieta	(532,593)	(1,120)
8 Shpenzime te tjera nga te tretet	(5,469,068)	(816,617)
9 Siguracione	-	
10 Komisione bankare	(73,444)	(37,188)
11 Shpenzime per materiale	(16,000)	
12 Transport	(140,290)	(5,605)
13 Trajnime	-	(41,724)
14 Shpenzime per energji elektrike dhe Uje	(119,784)	(30,937)
15 Shpenzime telekomunikacioni	(209,011)	(9,513)
16 Te tjera	(975,228)	(395,993)
Totali i shpenzimeve operative	(18,773,179)	(3,597,949)

10. Shpenzimet e tatimit mbi fitimin

Per vitin financiar 2015 shoqeria eshte e klasifikuar si biznes i vogel nen 2.000.000 leke dhe si e tille ka paguar tatim te thjeshtuar mbi fitimin nje shume fikse prej 25.000 leke.Me kete menyre taksimi nuk ka diferenca të perkoshme per aplikimin e tatimit te shrtyre.

11. Transaksione te paleve te lidhura

Palet konsiderohen ne pergjithesi te jene te lidhura ne qofte se palet jane nen kontroll te perbashket, ose njera pale ka aftesine per te kontrolluar palen tjeter ose mund te ushtroje ndikim te rendesishem mbi palen tjeter ne manjen e vendimeve financiare ose operationale. Kur konsiderohet cdo marredhenie ndermjet paleve, vemendje i kushtohet permbajtjes se marredhenies dhe jo thjesht formes ligjore.

12. Ngjarjet pas dates se bilancit dhe vazhdimesia e shfrytezimit

Nuk ka ngjarje të rëndësishme pas datës së raportimit, te cilat kerkojnë rregullime apo riparqitje në pasqyrat financiare.